

BANKA PËR BIZNES KODI I ETIKËS

JANAR 2020



BPB

Banka e vendit tënd

BANKA E VENDIT TËND



Një mesazh nga Kryeshefi Ekzekutiv

Banka për Biznes është bankë në rritje të vazhdueshme, zhvillim dhe mbështetje të të gjithë klientëve, të cilët na kanë besuar që ne të krijojmë shërbime inovative dhe produkte të dizajnuara veçanërisht për nevojat e tyre.

Kodi i Etikës së Bankës për Biznes paraqet vlerat dhe parimet tona, si dhe është ndërtuar në standardin që çdo relacion me klientët tanë, aksionarët, komunitetin dhe të punësuarit të jetë në përputhje me standardet bazë të sjelljes etike në biznes.

Besimi është një nga vlerat thelbësore mbi të cilin është ndërtuar banka jonë, gjithashtu është themeli mbi të cilin ne ndërtojmë marrëdhënie afatgjate profesionale me klientët tanë, aksionarët, komunitetin dhe të punësuarit. Përgjegjësia për krijimin dhe ruajtjen e besimit në BPB mbështetet thellësisht mbi secilin prej nesh dhe në integritetin personal që ne ofrojmë në punën tonë.

Ne do të angazhohemi në jetësimin e misionit dhe vizionit të bankës, gjithmonë me ndershmëri, integritet, transparencë, komunikim të hapur dhe përgjegjësi.

Kodi i Etikës, ndër të tjera, paraqet të gjitha informatat se si duhet zbatuar vlerat tona përderisa konkurrojmë në treg dhe angazhohemi me klientët, aksionarët, komunitetin dhe të punësuarit.

Faleminderit për punën tuaj dhe që kontribuoni të krijojmë mundësi për të gjithë ata të cilëve ju shërbejmë, si dhe për angazhimin tuaj personal për të ruajtur vlerat dhe standardet tona etike, çdo ditë.



Arton CELINA
Kryeshef Ekzekutiv

Arton Celina

Qëllimi i Kodit të etikës

Banka për Biznes është e angazhuar në standardet më të larta të sjelljes etike dhe profesionale. Kodi i Etikës së BPB-së përcakton parimet dhe praktikat themelore të punës, sjelljes profesionale dhe personale të cilat të gjithë punonjësit e bankës, Menaxhmenti Ekzekutiv dhe Bordi i Drejtorëve duhet t'i adaptojnë dhe të mbështeten në këto standarde.

Kodi i Etikës ka për qëllim të udhëzojë sjelljen tonë për të nxitur integritetin dhe besimin e publikut. Parimet dhe standardet e përmbledhura në këtë Kod, përshkruajnë të gjitha aktivitetet tona dhe marrëdhëniet me bashkëpunëtorët tonë, përfshirë klientët, kolegët, aksionarët, furnitorët, rregullatorët, partnerët e biznesit dhe gjithë shoqërinë. Këto parime dhe standarde formojnë

themelin për të gjitha politikat, udhëzimet dhe procedurat e BPB-së, të cilat janë në linjë me praktikat ndërkombëtare. Gjithsesi, Kodi nuk mund të adresojë çdo situatë me të cilën banka përballlet, mirëpo synon që të vendos themelet bazë të sjelljes sonë në raport me publikun.

Kodi i Etikës përmbushet edhe nga procedurat, udhëzimet e brendshme si dhe ligjet e rregulloret ne fuqi, për të siguruar që të gjithë punonjësit veprojnë me integritet dhe ndershmëri në të gjitha aspektet dhe janë përgjegjës për veprimet e tyre.

Kodi i Etikës së BPB-së, është korniza që përcakton standardin e qartë të sjelljes që duhet t'i përmbahemi të gjithë, gjithmonë duke ruajtur besimin e palëve të interesuara.

Zbatimi i Kodit të etikës

Të gjithë të punësuarit e Bankës, duhet të veprojnë sipas rregullave dhe standardeve të përcaktuara me Kodin e Etikës, i cili përcakton rregullat dhe standardet e brendshme për të gjithë të punësuarit e Bankës.

Rregullat dhe standardet e përcaktuara me këtë Kod, janë pjesë e kushteve të përgjithshme të punësimit dhe i njëjti përcakton të gjitha rregullat dhe standardet e pritura nga të gjithë të punësuarit. I njëjti, mbulon edhe detyrimet që burojnë pas ndërprerjes së marrëdhënies së punës me Bankën.

Shkeljet eventuale të Kodit të etikës, do të shqyrtohen dhe do të merren masa bazuar në procedurat e brendshme të Bankës.



Misioni i Bankës

Misioni i Bankes për Biznes është krijimi i bashkëpunimit të besueshëm dhe afatgjatë me ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, me qëllim që të mbështes rritjen dhe zhvillimin e tyre përmes produkteve dhe shërbimeve enkas të dizajnuara, të përgjegjshme dhe inovative. Ne u ofrojmë klientëve qasje të menjëhershme dhe të drejtpërdrejtë në shërbime financiare cilësore duke i plotësuar nevojat e tyre.

Për arsye se besimi është pika më e rëndësishme, ne jemi të përqendruar në ndërtimin dhe mbajtjen e marrëdhënieve afatgjata me klientët tanë, komunitetin, punëmarrësit dhe aksionarët tanë. Ne do t'i forcojmë këto marrëdhënie duke siguruar zgjidhjet e duhura që kombinojnë teknologjinë, përvojën dhe forcën financiare.

BPB do të jetë një ofrues që:

- ▶ Shton vlerë për klientët tanë;
- ▶ Krijon një ndikim pozitiv ekonomik në komunitetin tonë, dhe
- ▶ Krijon mundësi pozitive personale dhe profesionale për punonjësit tanë

Ndër të tjera, qëllimi ynë është të krijojmë klientelë besnike, të shtojmë vlerën afatgjatë të investimit të aksionarëve tanë dhe të kontribuojmë në zhvillimin dhe mbajtjen e të punësuarve tanë.

Vizioni i Bankës

Vizioni i Bankës për Biznes është;

- ▶ Të jetë Bankë e qëndrueshme për aksionarët
- ▶ Institucion kredibil për stafin tonë dhe
- ▶ Liderë në ofrimin e produkteve dhe shërbimeve financiare për ndërmarrje të vogla dhe të mesme në Kosovë.


Ne do të veprojmë në çdo kohë me ndershmëri dhe integritet për të fituar besnikërinë e punonjësve, klientëve dhe komunitetit tonë.



Vlerat e Bankës

Vlerat e bankës janë ato të cilat na identifikojnë dhe të gjithë të punësuarit inkurajohen t'i mbrojnë këto vlera si dhe të veprojnë në përputhshmëri të plotë me to.

Vlerat tona thelbësore në bazë të të cilave ne funksionojmë dhe të cilat na përfaqësojnë si Bankë, janë:



Orientimi ndaj klientit

Orientimi ndaj klientit paraqet qasjen tonë në të cilën klienti është në qendër dhe të gjithë ne angazhohemi për plotësimin e nevojave dhe kërkesave të klientit. Të gjitha veprimet dhe vendimet e bankës, merren duke pasur parasysh nevojat e klientit sepse vetëm kështu krijojmë relacione afatgjatë me klientët. Ne, gjithashtu, në çdo kohë jemi afër klientëve përmes të gjitha kanaleve të komunikimit, si dhe me ofrimin e shërbimeve dhe produkteve cilësore, ne përmbushim nevojat dhe tejkalojmë pritshmëritë e klientëve tanë

Përgjegjësia

Ne veprojmë në drejtim të ndërtimit të relacioneve të qëndrueshme dhe afatgjatë me klientë, të punësuar dhe palë të treta.

Ambienti i hapur dhe transparent na mundëson të jemi përkrahës, fleksibil dhe të adaptueshëm ndaj ndryshimeve. Ne jemi përgjegjës dhe inkurajojmë të punësuarit që të flasin për gjërat që i shqetësojnë në vendin e punës dhe sigurojmë trajtim të drejtë ndaj të gjithë punonjësve. Gjithashtu, duke dëgjuar mendimet e të tjerëve, ne respektojmë dinjitetin e tyre personal, privatësinë dhe të drejtat individuale. Në linjë me strategjinë e përgjithshme për të qenë "bankë e përgjegjshme", ne kujdesemi që, përmes veprimeve tona, të kontribuojmë në përmirësimin e statusit social të klientëve, pa dëmtuar mjedisin apo shoqërinë. Në këtë formë, ne jetësojmë vlerat e bankës, duke mbrojtur reputacionin personal dhe atë të institucionit

Transparenca

Qëllimi ynë është që të kemi një ambient pune ku besueshmëria ndaj njëri-tjetrit është element kyç i bashkëpunimit të shëndoshë. Për të arritur këtë, ne jemi transparent ndaj njëri-tjetrit si dhe ndaj palëve të treta, duke shpalosur informatat e nevojshme, qartë dhe me kohë. Objektivi i përbashkët është që të krijojmë ambient të besueshëm, ku secili ndihet i lirë të shprehë mendimin, si dhe rëndësi të veçantë ne i kushtojmë transparencës ndaj klientëve në lidhje me kushtet dhe rregullat e bashkëpunimit.

Zhvillimi dhe avancimi

Modeli i biznesit të Bankës tonë ka bërë hapa të mëdha të zhvillimit dhe avancimit, duke i dhënë theks të veçantë ngritjes së vazhdueshme profesionale të të punësuarve. Zhvillimi i Bankës ka bërë që sot të mund të krenohemi me transformimin e arritur dhe ata që kanë jetësuar këtë transformim janë pikërisht të punësuarit e Bankës të cilët përbëjnë asetin tonë më të çmuar. Zhvillimi i të punësuarve dhe investimi në ngritjen e kapaciteteve të të punësuarve, janë prioritet i joni me çrast ne synojmë të ju ofrojmë të punësuarve vend pune dinamik dhe me mundësi zhvillimi.

Integriteti

Integriteti është një nga vlerat tona thelbësore për funksionimin e biznesit dhe, duke vepruar me integritet, ne sigurohemi që çdo vendim i marrë të bazohet në parime tërësisht etike dhe morale. Besimi dhe ndershmëria janë elemente kyçe në bazë të të cilave ne ndërveprojmë dhe nga të gjithë të punësuarit presim që të veprojnë me integritet, të jenë të përgjegjshëm dhe të besueshëm dhe të trajtojnë me respekt bashkëpunëtorët, palët e interesit dhe klientët.

Komunikimi

Përkrahja e të punësuarve dhe transparenca në komunikim janë prioritet për ne. Mbështetja e stafit me këshillat profesionale është jetike për qëndrueshmëri dhe profesionalizëm në institucionin tonë. Ne komunikojmë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe transparente, si dhe përkrahim të gjithë të punësuarit në mënyrë që së bashku të realizojmë objektivat dhe strategjinë e Bankës. Duke praktikuar transparencën e plotë, duke shkëmbyer mendimet dhe opinionet tona, si me kolegët ashtu edhe me palët e treta, ne e promovojmë komunikimin efektiv brenda Bankës. Ne, me komunikim transparent, gjithashtu, kontribuojmë në shpalosjen e drejtë të informatave për klientët tanë dhe palët e interesit.

Rregullat dhe parimet e Bankës

Standardet e larta të Etikës në Bankën për Biznes përfshijnë një angazhim të lartë nga secili i punësuar i Bankës, veprime të ndershme dhe me integritet në raport me klientët, palët e treta dhe të punësuarit.

Të gjithë të punësuarit e Bankës duhet të veprojnë me përgjegjësi të plotë dhe sjellje profesionale, si dhe duhet të jenë shembull i punës së përgjegjshme dhe etikës profesionale.

Në mënyrë që të jetojmë sipas vlerave tona, ne duhet të respektojmë standardet dhe rregullat bazë. Përbushja e standardeve dhe rregullave të mëposhtme është e lidhur me vlerat tona.



Të punësuarit e Bankës

Ne kujdesemi që kultura e punës dhe respektimi i njëri tjetrit brenda Bankës nga të gjithë kolegët të jetë në nivelin e duhur si dhe sigurohemi të kemi një ambient pune me të drejta të barabarta për të gjithë të punësuarit, ku secili i punësuar ka të drejtën e plotë të komunikimit të hapur dhe shprehjes së mendimit të lirë.

Banka zbaton Ligjet dhe rregulloret përkatëse mbi të drejtat e të punësuarve, përfshirë edhe kujdesin mbi shëndetin dhe sigurinë në punë si dhe ndalon diskriminimin apo ngacmimin në vendin e punës.

Të punësuarit mund të pranojnë apo ofrojnë vetëm dhurata simbolike, duke qenë subjekt i kriterëve dhe aprovimeve të vendosura në rregullat tona të brendshme. Dhuratat në formë të parasë së gatshme, nuk lejohet të jepen apo pranohen në asnjë rrethanë.

Të punësuarit e Bankës, duhet të ruajnë dhe trajtojnë me përgjegjësi të plotë pajisjet e Bankës apo asetet duke mos përjashtuar edhe informatat konfidenciale, pronën intelektuale, etj të Bankës, të klientëve apo palëve të treta.

Të punësuarit e Bankës nuk duhet të jenë të përfshirë në aktivitet që ndikojnë në prishjen e imazhit apo reputacionit të Bankës si dhe obligohen që të mënjanojnë çfarëdo konflikti të mundshëm të interesit.

Të punësuarit e Bankës përfshirë Menaxhmentin e lartë si dhe anëtarët e Bordit, nuk duhet të përfshihen në ndonjë aktivitet që ka konflikt interesi me përgjegjësitë dhe fushëveprimin e tyre në Bankë. Të punësuarit duhet të evitojnë çdo konflikt të mundshëm interesi, si dhe për çdo paqartësi apo paraqitje të një konflikti të mundshëm interesi, duhet të njoftojnë Mbikqyrësinë direkt dhe Departamentin e Burimeve Njerëzore.



Klientët e Bankës

Ne trajtojmë me përgjegjësi të plotë dhe mbrojmë interesat e klientëve dhe sigurohemi se të gjitha shërbimet dhe produktet e Bankës, janë të dedikuara që të plotësojnë nevojat e klientëve. Të punësuarit e Bankës, janë të përgaditur dhe të trajnuar që të ofrojnë shërbime sa më cilësore dhe në kohë për të gjithë klientët. Banka, gjithashtu investon në avancimin e vazhdueshëm të shërbimeve në mënyrë që klientëve të ju ofrohen shërbime cilësore dhe në kohë.

Të gjithë të punësuarit e Bankës janë të udhëzuar që të komunikojnë në mënyrë transparente me klientët dhe të trajtojnë çdo ankesë eventuale që mund të ngritet nga ana e tyre ndaj Bankës.

Konflikti i interesit, mbrojtja e të dhënave dhe konfidencialiteti

Ne sigurohemi se interesat e të punësuarve të Bankës, nuk janë në konflikt me detyrat dhe përgjegjësitë e tyre ndaj Bankës por edhe ndaj klientëve. Qështjen e trajtimit të konfliktit të mundshëm të interesit, ne e trajtojmë me rregullore të brendshme të Bankës.

Ne kujdesemi të jemi në përputhshmëri të plotë me Ligjet dhe rregulloret në fuqi dhe mbrojmë të dhënat personale të klientëve si dhe të të dhënat e të punësuarve.

Të punësuarit duhet të trajtojnë me përgjegjësi dhe në konfidencialitet të plotë të gjitha të dhënat personale të klientëve. Banka për Biznes mbështetet në standartet dhe procedurat e brendshme të ruajtjes së të dhënave personale dhe parandalon që persona të paautorizuar të kenë qasje në të dhënat personale të klientëve.



Përputhshmëria me Ligjet dhe Rregulloret

Ne jemi të përkushtuar që veprimtaria jonë të jetë në harmoni me kornizën rregullative, standarde vendore dhe ato ndërkombëtare me qëllim të rritjes së besueshmërisë së klientëve dhe rritjes së Bankës në baza të shëndosha. Sigurimi i pajtueshmërisë së Bankës me këto standarde është ndër prioritetet e Bankës.

Qëllimi ynë është që të rritemi dhe të realizojmë strategjinë tonë të Biznesit në mënyrë të drejtë dhe të qëndrueshme në raport me tregun, autoritetet dhe ligjet dhe rregulloret në fuqi. Prandaj, ne veprojmë dhe jemi në përputhje të plotë me ligjet, rregullat dhe rregulloret në fuqi.

Të punësuarit e Bankës, duhet të veprojnë dhe të njohin kërkesat rregullatore që aplikohen për fushën të cilën ata e mbulojnë në Bankë. Banka përmes kanaleve të brendshme të komunikimit, sigurohet të njoftojë të punësuarit lidhur me ndryshimet në ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Lufta kundë krimit financiar

Lidhur me parandalimin e pastrimit të parasë, ne aplikojmë praktikën më të mira bankare me qëllim të mbrojtjes nga shfrytëzimi i shërbimeve dhe produkteve të Bankës për pastrimin e parave apo aktivitetet e financimit të terrorizmit. Banka për Biznes mbështet luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit duke zbatuar parimin bazë "Njih Klientin Tuaj", me ç'rast Banka themelon relacione bankare me ata klientë që ka arritur t'i identifikojë dhe verifikojë se me relacionet e krijuara, Banka është siguruar që aktiviteti i klientëve është në pajtueshmëri me kërkesat dhe standardet e Bankës.

Ne kujdesemi të jemi në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi sa i përket parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit si dhe kujdesemi që të punësuarit të jenë të trajnuar për identifikimin dhe raportimin e rasteve të dyshimta. Të punësuarit e Bankës janë përgjegjës të ndihmojnë në sigurimin e pajtueshmërisë me politikat e Bankës kundër pastrimit të parave.

Komunikimi me media

Të gjitha komunikimet me palët e jashtme, përkatësisht me media bëhen vetëm përmes Departamentit të Marketingut. Nëse ndonjë i punësuar kontaktohet direkt nga ndonjë media për prononcim rreth ndonjë çështje në lidhje me Bankën, atëherë obligohet që paraprakisht të marrë aprovim nga personat përgjegjës dhe vetëm personat e autorizuar mund të komunikojnë me media në emër të Bankës.

Rregullat e mirësjelljes në raport me konkurentët

Banka operon në një ambient gjithnjë e më shumë konkurrues dhe të punësuarit udhëzohen që të veprojnë në mënyrë profesionale në raport me të gjithë konkurentët. Gjithashtu, nga të punësuarit e Bankës për Biznes, pritet që të përmbahen nga deklaratat që vënë në pikëpyetje sjelljen profesionale të konkurrentëve të Bankës për Biznes.

Përgjegjësia sociale dhe mjedisore

Ne e trajtojmë me shumë rëndësi rolin tonë drejt përgjegjësisë sociale. Në përputhje me slloganin tonë "Banka e vendit tënd", BPB përpiqet që përmes aktiviteteve të ndryshme të rrisë cilësinë e jetës në shoqëri.

Ne gjithashtu, angazhohemi që të përkrahim bizneset inovative që kanë për qëllim mbrojtjen e mjedisit. Ndër të tjera, ne kujdesemi që të mos përfshihemi në marrdhënie biznesore me palë të treta apo me klientë, të cilët nuk zbatojnë parimet e njëjta mbi mbrojtjen e mjedisit dhe përgjegjësinë sociale.





Rr. Ukshin Hoti, nr. 128,
Prishtinë 10 000, Kosovë



+383 (0) 38 620 620
0800 50000



/bpb.bank/



/bankaevendit/